

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR "AMADEUS TRAWELL AND TOURS" SH.P.K.

Ne Tirane, sot ne date 05 Korrik2014, ortakui vetem i shoqerise redaktoi kete statut, përsheqërinëme përgjegjësi te kufizuar me emërtimin "AMADEUS TRAWELL AND TOURS" shpk per sa vijon:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore

Shoqëria është një person juridik Shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisëme Përgjegjësi te Kufizuar, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Shoqëria do të drejtojë aktivitetin tregtar sipas Legjislacionit Shqiptar dhe dispozitave tëdokumenteve të themelimit.

Neni 2

Emërtimi

Emri i shoqërisë është "AMADEUS TRAWELL AND TOURS" ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.p.k, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjesi te Kufizuar.

Shoqëria "AMADEUS TRAWELL AND TOURS " sh.pk. do të ketë logon dhe vulën e saj e cila aprovohet nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jete:

- Ne fushen e transportit ajror, detar, tokesor, agjensi per shitjen e biletave ajrore dhe te shoqerive ajrore, detare, tokesore, ne fushen e turizmit. Agjent i transferimit te parave me dhe per llogari te subjektit financiar jo banke, zyre kembimi valutor.

Përshkrimi i objektit te shoqërisë ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Per realizimin e qellimitesajshoqeriamundtebashkepunoje me çdo person fizikapojuridik ne çdomenyreqe e gjykontedobishme.

Shoqeria ne çdokohemundteripercaktojeobjektin e saj, ta shtojeapopakesoje ate, me vendimteasamblese se shoqërisë.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: rruga e Abdyl Toptani, tek Torre DRIN. Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes sëpërgjithshme tëasamblesë së shoqërisë.

Neni 6

Regjistrimi i Kapitalitdhe Ortaket

Kapitali Themeltar i Shoqërisëështë2,500,000 (dy milion e pesëqindmijë) leke dhe është i ndare ne 2500 (dy mijë e pesëqind) kuota me vlere nominale 1,000 (një mijë) leke secila. Kapitali i shoqerise zotërohet 100% nga ortakui i vetëm i shoqërisë, Z. Gjergji Sollaku.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi ikapitalit



Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.

Rritja e kapitalit mund të fillojë me emetimin e kuotave të reja ose duke rritur vlerën e kuotave ekzistuese.

Zvogëlimi i kapitalit do të autorizohet nga vendimi i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme.

Drafti për zvogëlimin e kapitalit do të komunikohet ekspertëve kontabël të licencuar, të paktën 45 ditë para procedimit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, e cila do të mbledhet në mënyrë specifike për të vendosur këtë draft. Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme do të marrë këtë vendim bazuar mbi raportin e ekspertit kontabël.

Të gjitha procedurat për zvogëlimin e kapitalit do të kryhen në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 8 Organet Drejtuese

Asambleja e Ortakeve,

Administratori.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit prej organeve të shoqërisë janë të parashikuara me gjerësisht në vijim.

Neni 9 Asambleja e përgjithshme

1. Të drejtat e ortakeve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme e përberë nga ortakët e saj.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin, revokimin e administratorit;

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Pavaresisht nëse shoqëria zotërohet nga një apo shumë ortakë, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga çdo ortak. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;

ç) vendimet për investime;

d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Neni 10 Administratori

Emërimi i Administratorit të shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori për një afat 5 (pese) vjet dhe me të drejtë rimërimi do të jetë:



- **Enkela Sollaku**, e bija e Hilmiut dhe e Erjetes, e dtl. 10 Mars 1967, lindur ne Tiranë dhe banuese ne Tirane, me nr. Karte Identiteti 024405282, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi juridike dhe për te vepruar,
- Administratori ka këto kompetenca:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatise dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
 - e) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - e) të raportojë përpara asamblesë për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 11

Auditimi Financiar

Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme emëron ekspert të certifikuar kontabël si auditor të pavarur për periudhën e përcaktuar me ligj. Auditori i pavarur do të jetë emëruar për një periudhë të pacaktuar.

Shoqëria ka të drejtën të emërojë një ose me shumë auditorë.

Auditorët e pavarur do të kenë të drejtën për të analizuar të gjitha rastet e devijimit të procedurave ligjore fiskale të kryera nga Aksionerët, në mënyrën e përcaktuar në Ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 12

Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti financiar, Administratorët përgatisin inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, do tu kalojë aksionarëve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë ose mund të kalojë për investime me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Mbledhje e Zakonshme).

Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, përveç fondeve të parashikuara në nenin e mësipërm.

Neni 13

Prishja e Shoqërisë

Shoqëria prishet:

- a) Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) Me hapjen e një procedure falimentimi;
- c) Nëse nuk ka kryer aktivitet tregtare për periudhën e përcaktuar në ligj;
- d) Me vendim të Gjykatës.

Neni 14

Likuidimi i Shoqërisë

Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim, kur miraton një vendim me këtë objekt të propozuar nga administratorët.

Për këtë qëllim, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, emëron një a më tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

Neni 15

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Të gjitha çështjet që nuk gjejnë një rregullim tëposaçëm në këtë statut, nëmarrëveshje me palët, do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil në fuqi apo nga dispozitat e Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" në fuqi si dhe Ligjit "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontablit të miratuar".

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të këtij STATUTI, si dhe midis Ortakëve të shoqërisë, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 16

Dispozita të Fundit

Ky statut është redaktuar nga aksionerët në 4 (kater) ekzemplarë me vlerë të njëjtë juridikë në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

GJERGJI SOLLAKU

Gjergji Sollaku

